

**1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2022**

**1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar mungesën e likuiditetit në sistemin bankar**

**Tabelë 1:** Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë<sup>1</sup>)

| <b>DATA</b>            | <b>R/REPO<br/>njëditore</b> | <b>R/REPO<br/>njëjavore</b> | <b>R/REPO<br/>&gt;1javë<br/>&lt;3muaj</b> | <b>REPO<br/>Njëditore</b> | <b>Totali i<br/>likuiditetit të<br/>injektuar</b> |
|------------------------|-----------------------------|-----------------------------|---|---------------------------|---|
| <b>7-korrik-22</b>     |                             | 24.89                       |   |                           | 43.56   |
| <b>14-korrik-22</b>    |                             | 23.73                       |   |                           | 42.40   |
| <b>21-korrik-22</b>    |                             | 29.11                       |   |                           | 47.79   |
| <b>25-korrik-22</b>    |                             |                             | 6.15                                      |                           | 49.28   |
| <b>28-korrik-22</b>    |                             | 24.28                       |   |                           | 44.45   |
| <b>4-gusht-22</b>      |                             | 23.19                       |   |                           | 43.36   |
| <b>11-gusht-22</b>     |                             | 23.76                       |   |                           | 43.93   |
| <b>18-gusht-22</b>     |                             | 21.15                       |   |                           | 41.32   |
| <b>24-gusht-22</b>     |                             |                             | 6.26                                      |                           | 40.83   |
| <b>25-gusht-22</b>     |                             | 23.85                       |   |                           | 43.52   |
| <b>1-shtator-22</b>    |                             | 17.66                       |   |                           | 37.34   |
| <b>8-shtator-22</b>    |                             | 20.56                       |   |                           | 40.23   |
| <b>15-shtator-22</b>   |                             | 27.78                       |   |                           | 47.46   |
| <b>22- shtator -22</b> |                             | 27.34                       |   |                           | 47.01   |
| <b>25- shtator-22</b>  |                             |                             | 6.82                                      |                           | 46.58   |
| <b>29- shtator -22</b> |                             | 27.76                       |   |                           | 47.00   |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e tretë të vitit 2022, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë ka qenë 43.8 miliardë lekë, me një rënie minimale për 180 milionë lekë nga niveli i 3-mujorit të

<sup>1</sup> Shifrat janë në vlerë likuiditeti.


## Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022

mëparshëm dhe mbi mesataren e 12 muajve të fundit prej 40.2 miliardë lekësh. Mungesa ka ruajtur prirjen rritëse, duke qëndruar pranë niveleve maksimale prej 47 miliardë lekësh në fund të periudhës.

Në 2 muajt e parë të periudhës, rritja e parasë në qarkullim për në total 9 miliardë lekë ka qenë faktori kryesor i mungesës së lartë, ndërsa gjatë muajit shtator, kur paraja në qarkullim ka rënë me 6.16 miliardë lekë, akumulimi i likuiditetit në llogarinë e qeverisë ka mbajtur mungesën e likuiditetit në nivele të larta. Llogaria e qeverisë është rritur me 4.4 miliardë lekë gjatë muajit shtator dhe MFE-ja ka ulur marrëveshjen SWAP për 8.18 miliardë lekë në datën 15 shtator.

Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor për mesatarisht 24.3 miliardë lekë, kundrejt 30.3 miliardë lekëve dhe 20.1 miliardë lekëve në periudhat paraardhëse ose 55.4%. Injektimet 3-mujore janë mbajtur pothuaj të pandryshuara rreth nivelit 19.50 miliardë lekë.

**Grafik 1. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2022 (me vlerë nominale)**



**Burimi: Banka e Shqipërisë.**

## **1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme**


Sistemi bankar ka përdorur instrumentin e depozitës në BSH, në mënyrë të vazhdueshme, për mesatarisht 10.14 miliardë lekë, kundrejt 6.84 miliardë lekëve në 3-mujorin e mëparshëm.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur vetëm në 1 rast gjatë 3-mujorit të tretë, kundrejt asnjë rasti në 3-mujorin e mëparshëm dhe vetëm në 5 raste për shumat 30-450 milionë lekë në 3-mujorin e parë të vitit 2022.

## **1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e Bankës së Shqipërisë**

Gjatë 3-mujorit të tretë të vitit 2022, portofoli i Bankës së Shqipërisë është rritur me 343 milionë lekë pas rritjes me të njëjtën shumë në 6 muajt e parë të vitit. Vlera e portofolit ka qenë 66.3 miliardë lekë në fund të muajit shtator. Pavarësisht prirjes për rritje të mungesës së likuiditetit në sistemin bankar, operacionet e Bankës së Shqipërisë kanë synuar mbajtjen e portofolit në nivele të pandryshuara gjatë 3-mujorit, rinovimin e pjesshëm të portofolit në tregun sekondar dhe ulje të pjesëmarrjes në disa emetime ku zotërimi ka qenë i lartë. Janë maturuar në tregun primar 2.15 miliardë lekë dhe janë blerë në 6 ankande 2.50 miliardë lekë bono thesari.

Grafik 2. Portofoli i Bankës së Shqipërisë (në mld lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës nuk ka pasur operacione rregulluese.

## **2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2022**

### 2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë 3-mujorit të 3-të të vitit 2002, sikurse lajmëruar më 21 dhjetor 2021, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar 4 ankande për blerjen e valutës.

## Kalendari i ndërhyrjeve në treg - Viti 2022

|    | Data       | Shuma Raundi I (në euro) |
|----|------------|--------------------------|
| 1  | 18/02/2022 | 5-8 mln                  |
| 2  | 17/03/2022 | <b>anuluar</b>           |
| 3  | 13/04/2022 | <b>anuluar</b>           |
| 4  | 27/04/2022 | <b>anuluar</b>           |
| 5  | 13/05/2022 | 5-8 mln                  |
| 6  | 03/06/2022 | 5-8 mln                  |
| 7  | 17/06/2022 | 5-8 mln                  |
| 8  | 12/07/2022 | 5-8 mln                  |
| 9  | 22/07/2022 | 5-8 mln                  |
| 10 | 05/08/2022 | 5-8 mln                  |

**Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022**

---

|           |            |         |
|-----------|------------|---------|
| <b>11</b> | 19/08/2022 | 5-8 mln |
| <b>12</b> | 18/10/2022 | 5-8 mln |
| <b>13</b> | 18/11/2022 | 5-8 mln |
| <b>14</b> | 05/12/2022 | 5-8 mln |
| <b>15</b> | 16/12/2022 | 5-8 mln |

**Shënim: Me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon të blejë përmes ankandëve 140-200 mln euro gjatë vitit 2022.**

Oferta e ardhur nga bankat e nivelit të dytë në të 4-ta ankandët ka qenë e lartë, duke bërë që të blihen 49.2 mln euro kundrejt 47.20 mln eurove të blera në 4 ankandët e mëparshme në vitin 2022. Në 9 muajt e parë të vitit, pas anulimit të 3 ankandëve në periudhën mars-prill, janë blerë 96.40 mln euro.

## **2.2 Veprime me institucione të tjera**

Gjatë 3-mujorit, MFE-ja ka rritur përkohësisht shumën e marrëveshjeve SWAP të pamaturuara me 8.18 miliardë lekë në datën 9 gusht, për ta ulur sërish për të njëjtën shumë. Marrëveshjet SWAP të pamaturuara mbeten sërish në 20.80 miliardë lekë, kundrejt 35.80 miliardë lekëve në fund të vitit 2021. Marrëveshjet e SWAP të pamaturuara paraqiten si më poshtë:

1. 40 mln euro në 30 nëntor 2022;
2. 79 mln euro në 29 dhjetor 2022;
3. 50 mln euro në 30 dhjetor 2022.

Gjatë 3-mujorit, Banka e Shqipërisë ka blerë 2.14 mln euro nga programi IPA i MFE-së dhe 1.12 mln euro nga IBRD-ja.